



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMI
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.477/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues dhe z. Blerim Dina- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Lulzim Katanolli B.I”, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Dezinfektimi i objekteve për nevojat e komunës së Prishtinës” me nr. të prok: 20-3281-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - KK Prishtinë, me datë 20.08.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APPROVATION, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Lulzim Katanolli B.I”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Dezinfektimi i objekteve për nevojat e komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 20-3281-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - KK Prishtinë.

II. OBLIGATION, Autoriteti Kontraktues ti bëjë ndryshimet e nevojshme në dosje e tenderit në pajtim me dispozitat ligjore dhe të zgjasë afatin për ofertë, lidhur me aktivitetin të prokurimit: “Dezinfektimi i objekteve për nevojat e komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 20-3281-2-2-1, iniciuar nga AK - KK Prishtinë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Lulzim Katanolli B.I”, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik “Lulzim Katanolli B.I”, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 20.07.2020 me nr. 477/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi i objekteve për nevojat e komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 20-3281-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - KK Prishtinë duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1,7,28,65 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organji Shqyrtyes i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.07.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtyes dhe atë teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtyes dhe ai teknik i prokurimit në raportin e dt: 05.08.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqarojnë si në vijim:

Pretendimi nr.1

Pretendimi 1 (LPP/Neni 1: Qëllimi): Autoriteti kontraktues shkel të 3 paragrafët e nenit 1 të ligjit për prokurim publik. Përderisa parografi 1 thotë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbyshen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tillë. Autoriteti kontraktues e shkel nenin 1 të LPP-së me rastin e vendosjes së kritereve diskriminuese. Ku vendosja e kritereve të tillë aludon në operatorët selektiv.

Pretendimi 2 (LPP/Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi): Paragrafi 1.

Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Me këtë rast Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të këtij paragrafi dhe të Nenit 7 të LPP_se në përgjithësi pasi që Autoritreti Kontraktues në dosjen e tenderit tek specifikacioni teknik ka specifikuar kërkuesën:

1.KOSTATIMI 1.Nuk qëndron ky pretendim ankimor, nr. 2 sepse duke e pasur parasysh se ky virus është shpall pandemi botërore, edhe duhet të jetë e caktuar përbërja aktive e Dezinfektuesit për procesin DDD. Përbërja aktive e dezinfekuesit:

3,35g Didecyldimethylammoniumchlorid, 3,35g Quaternary ammonium, benzyl-C12- C16-alkyldimethylchlorid, 3,3g Quaternary ammonium,C12-14-Alkyl[(ethylphenyl)methyl]dimethyl-, Chloride, Isopropanol.

Ky specifikacion teknik është diskriminues dhe selektiv ngase autoriteti kontraktues ka vendosur vetëm një komponim dezinfektues, e aq më tepër duke vendosur edhe gramazhë për çdo përbërës. Duke e ditur se ka shumë komponime (preparate) dezinfektuese për luftimin e COVID-19 në bazë të komponimeve aktive të ammoniumit (ku ekzistojnë mëse 400 komponime, e varësishë nga shkaktari bëhen edhe komponimet dhe në bazë të asaj lëshohet edhe referenca nga organet kompetente, e ne rastin tonë flitet për komponimin aktiv të ammoniumit me reference për eliminim të COVID-19), komponimeve të peroksid hidrogjenit (H_2O_2).

KOSTATIMI 2 Ky pretendim qëndron pjesërisht, edhe duhet të jetë e caktuar përbërja aktive e Dezinfektuesit për procesin DDD, pasi që veç janë të testuara komponimet e aktiv të ammoniumit me referencë për eliminim të COVID-19), komponimeve të peroksid hidrogjenit (H_2O_2).

Pretendimi 3 (LPP/ Neni 28 i LPP-së- Specifikimet teknike): Autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit ka specifikuar se përbërja aktive e dezinfekuesit duhet të jetë: 3,35g Didecyldimethylammoniumchlorid, 3,35g Quaternary ammonium, benzyl-C12-C16- alkyldimethylchlorid, 3,3g Quaternary ammonium,C12-14-Alkyl[(ethylphenyl)methyl]dimethyl-, Chloride, Isopropanol. Duke vendosur vetëm një komponim të detajuar me gramazhë për çdo përbërës, autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 28 përkatësisht paragrafit 2 të këtij neni ku specifikohet se Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. Dhe ka shkelur paragrafin 7 ku thuhet se Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose

ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshmë të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij nenit ose ndryshtë; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët “ose ekuivalent”.

Autoriteti kontraktues ka bërë shkeljen e nenit 28 të LPP-së përkatësisht të nenit 3 ku thuhet Specifikimet teknike do të formulohen ose duke iu referuar standardit të aplikueshmë, specifikimit, miratimit apo referencës teknike që kërkohet sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni ose si një alternative lidhur me kërkesat e ekzekutuese ose funksionale, duke përfshirë karakteristikat mjedisore sipas paragrafit 9. të këtij neni. Autoriteti kontraktues mund të zgjedhë që të përdorë standardet ose specifikimet tjera sipas paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni për karakteristika të caktuara dhe kërkesat e ekzekutuese ose funksionale për karakteristika tjera. Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të këtij paragrafi me rastin e eliminimit të standardeve ndërkombëtare sa i përket referencave për luftimin e COVID-19, duke e ditur se ka shumë komponime (preparate) dezinfektuese për luftimin e COVID-19 në bazë të komponimeve aktive të amoniumit (ku egzistojnë mëse 400 komponime, e varësish nga shkaktari bëhen edhe komponimet dhe në bazë të asaj lëshohet edhe referenca nga organet kompetente, e në rastin tonë flitet për komponimin aktiv të amoniumit me reference për eliminimin e COVID-19), komponimeve të peroksid hidrogjenit (H_2O_2).

Autoriteti kontraktues në kërkesën 9 tek neni 9.1&9.2 Kapacitet teknike dhe profesional të dosjes së tenderit është kërkuar Dezinfektuesit adekuat për eleminimin e Covid -19, me dëshmi Atestet, certifikata e analizës për dezinfektim me fokus kundër Covid -19, ndërsa nuk është kërkuar letër reference për dezinfektuesin që ka ndikim në eliminimin e COVID-19 e lëshuar normalisht nga organet kompetente:

CDC-Centers for Disease Control;

ËHO- Ëorld Health Organization;

ECDC- European Centers for Disease Control

KOSTATIMI 3 edhe ky pretendim qëndron pjesërisht, edhe duhet të jetë e caktuar përbërja aktive e Dezinfektuesit për procesin DDD, pasi që veç janë të testuara komponimet e aktiv të amoniumit me reference për eliminimin të COVID-19), komponimeve të peroksid hidrogjenit (H_2O_2), por jo edhe në detale në mënyrë shumë te hollësishme dhe plotësisht ka të drejtë OE ankues, ndërsa nuk është kërkuar letër reference për dezinfektuesin që ka ndikim në eliminimin e COVID-19 e lëshuar normalisht nga organet kompetente:

CDC-Centers for Disease Control;

ËHO- Ëorld Health Organization;

ECDC- European Centers for Disease Control

Pretendimi 4 (LPP/Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve): Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 108/A me rastin e rishqyrtimit të kërkesës sonë. Mjafton t'i shihni përgjigjet ne 3 pretendimet tonë. Ne pretendimin e parë ka thënë se gramazha e cekur nuk e kufizon numrin e dezinfektueseve. Qysh është e mundshme të ketë një përgjigje të tillë autoriteti kontraktues. Një gramazhë e cekur e përberjes aktive të dezinfektuesit siç e ka vendos AK në specifikacionin teknik të kësaj dosje tenderike jo që e specifikon por i eliminon komplet dezinfektuesit tjerë e me këtë rast edhe operatorët ekonomik tjerë. Duke parë qëllimin e kësaj kontrate që është luftimi i COVID-19, ne ju kemi ofruar sugjerimet e organeve kompetente që merren me luftimin e COVID-19 (CDC-Centers for Disease Control; ËHO- Ëorld Health Organization; ECDC- European Centers for Disease Control), ndërsa autoriteti kontraktues ka ofruar në specifikacion një dezinfektues i cili nuk ka referencë për luftimin e COVID-19. Pra autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 te LPP-se si dhe nenin 28 te LPP-se.

Ky specifikacioni i autoritetit kontraktues nuk është profesional dhe as ligjor për luftimin e COVID-19, si dëshmi është mungesa e referencës për luftimin e COVID19 nga organet kompetente që merren me luftimin e COVID-19 (CDC-Centers for Disease Control; ËHO- Ëorld Health Organization; ECDC- European Centers for Disease Control).

KOSTATIMI 4, nuk qëndron sepse edhe duhet të jetë e caktuar përbërja aktive e Dezinfektuesit për procesin DDD, pasi që veç janë të testuara komponimet e aktiv te ammoniumit me reference për eliminim te COVID-19), komponimeve të peroksid hidrogenit (H_2O_2), por jo edhe ne detale në mënyrë shumë te hollësishme dhe plotësisht ka të drejtë OE ankues, sepse AK ka treguar dhe ka sqaruar se në gramazhë që masa, sasia dhe cilësi e kompnimeve për procesin e DDD duhet të jetë në forme standarde edhe jo përzierjet e komponimeve të jenë më të holluara në gramazhë që nuk do të kenë efekt kundrejt cov 19, apo edhe jo shumë të përqendruara sa mund ta dëmtojnë edhe florën e faunen apo edhe njërvimin, nëse janë me përqendrimi në gramazha më të larta se sa standartet.

Pretendimi 5 (LPP/Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve):

Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 65, përkatësisht paragrafin 1 ku thot:

1. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj:

1.1. ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues; ose

1.2. ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjesë të ndonjë pjesë të këtyre të fundit.

1.3. Duke qenë në cilindo rast në një konflikt interesit, siç përcaktohet në nenin 4, paragrafi 1.75., me rastin e vendosjes së një specifikacioni të tillë teknik rezulton se neni i mësipërm i LPP-së me të 3 nënparagrafët është shkelur nga ana e autoritetit kontraktues. Edhe pse jemi në fazën tenderuesi, ne po e specifikojmë këtë për arsy se ka të bëjë me specifikacionin teknik dhe kur ne shohim se specifikacioni teknik është i orientuar, i dedikuar dhe i specifikuar në atë mënyrë që i eliminon të gjithë dezinfektuesit tjerë e rrjedhimisht operatorët tjerë padrejtësisht. E aq më shumë kur qëllimi i kësaj kontrate është luftimi i COVID-19 dhe ne shofim se kërkesa e dezinfektuesit as nuk ka referencë për luftimin e COVID-19.

Shënim:

Qysh është e mundshme që autoriteti kontraktues të përgjigjet në pretendimet tona ankimore në kërkesën për rishqyrtim në mënyrë të tillë jo-professionale. Një gramazhë e cekur e përbërjes aktive të dezinfektuesit siç e ka vendos AK në specifikacionin teknik të kësaj dosje tenderike jo që e specifikon por i eliminon komplet dezinfektuesit tjerë e me këtë rast edhe operatorët ekonomik tjerë. Duke parë qëllimin e këesaj kontrate që është luftimi i COVID-19, ne ju kemi ofruar sugjerimet e organeve kompetente që merren me luftimin e COVID-19 dhe Listën nga EPA (Environmental Protection Agency- Agjenci i përmirësuar e Mbrojtjen e Ambientit) në të cilën paraqiten 431 preparate Dezinfektuese në bazë të komponimeve të ndryshme, të preferuara edhe nga (CDC-Centers for Disease Control; WHO- World Health Organization; ECDC- European Centers for Disease Control), ndera autoriteti kontraktues ka ofruar ne specifikacion një dezinfektues i cili nuk ka reference për luftimin e COVID-19. Pra autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 te LPP-se si dhe nenin 28 te LPP-se.

Ky specifikacioni i autoritetit kontraktues nuk është profesional dhe as ligjor për luftimin e COVID-19, si dëshmi është mungesa e referencës për luftimin e COVID-19 nga organet kompetente që merren me luftimin e COVID-19 (CDC-Centers for Disease Control; WHO- World Health Organization; ECDC- European Centers for Disease Control).

Bazuar në krejt çka kemi thënë më lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që pas shqyrtimit të ankesës sonë dhe marrjes për bazë të fakteve të përmendura nga ne.

KOSTATIMI 5, është e bazuar sepse kërkesa e dezinfektuesit as nuk ka reference për luftimin e COVID-19. Ndërsa autoriteti kontraktues ka ofruar në specifikacion një dezinfektues i cili nuk ka referencë për luftimin e COVID-19, pra autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar dhe zbatuar nenin 7 të LPP-se si dhe nenin 28 të LPP-së dhe se ky specifikacioni i autoritetit kontraktues nuk është profesional dhe as ligjor për luftimin e COVID-19, sepse ka mungesa dëshmive faktike dhe të argumentuara dhe se është mungesa e

referencës për luftimin e COVID19 nga organet kompetente qe merren me luftimin e COVID-19 (CDC-Centers for Disease Control; WHO- World Health Organization; ECDC- European Centers for Disease Control).

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar, te behet përmirësimi i kërkesave dhe konform nenit 25 te rregullores dhe udhëzuesit operativ per prokurim publik te beje zgjatjen e afatit per dorëzimin e ofertave.

Autoriteti Kontraktues, me datën 10.08.2020 me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, nuk e ka njoftuar OSHP-në se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 20.08.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për konratë, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e parë dhe të dytë të operatorit ekonomik ankues “Lulzim Katanolli B.I”, se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, pasi autoriteti kontraktues shkel të 3 paragrafët e nenit 1 të ligjit për prokurim publik me rastin e vendosjes së kritereve diskriminuese. Ku vendosja e kritereve të tillë aludon në operatorët selektiv. Më tej, OE ankues shton se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së pasi ka vendosur përbërjen aktive të dezinfektuesit

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se pretendimi i parë ankimore nuk është i bazuar pasi që duke e pasur parasysh se ky virus është shpall pandemi botërore, edhe duhet të jetë e caktuar përbëra aktive e Dezinfektuesit për procesin DDD.

Kurse, sa i përket pretendimit të dytë që ka të bëjë me përbërjen aktive të dezinfekuesit: 3,35g Didecyldimethylammoniumchlorid, 3,35g Quaternary ammonium, benzyl-C12- C16-alkyldimethylchlorid, 3,3g Quaternary ammonium,C12-14-Alkyl[(ethylphenyl)methyl]dimethyl-, Chloride, Isopropanol, ku OE ankues potencon se ky specifikacion teknik është diskriminues dhe selektiv ngase autoriteti kontraktues ka vendosur vetëm një komponim dezinfektues, e aq më tepër duke vendosur edhe gramazhë për çdo përbërës.

Duke e ditur se ka shumë komponime (preparate) dezinfektuese për luftimin e COVID-19 në bazë të komponimeve aktive të ammoniumit (ku ekzistojnë më se 400 komponime, e varësishtë nga shkaktari bëhen edhe komponimet dhe në bazë të asaj lëshohet edhe referenca nga organet kompetente, e ne rastin tonë flitet për komponimin aktiv të ammoniumit me reference për eliminim të COVID-19), komponimeve të peroksid hidrojenit (H_2O_2).

Paneli Shqyrutes konform ekspertit shqyrties/teknik sqaron se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar pasi që duhet të jetë e caktuar përbërja aktive e dezinfektuesit për procesin DDD, pasi që veç janë të testuara komponimet e aktiv të ammoniumit me referencë për eliminim të COVID-19), komponimeve të peroksid hidrojenit (H_2O_2).

Lidhur me pretendimin e tretë të OE ankues se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së - Specifikimet teknike, duke specifikuar në dosje të tenderit se përbërja aktive e dezinfekuesit duhet të jetë: 3,35g Didecyldimethylammoniumchlorid, 3,35g Quaternary ammonium, benzyl-C12-C16-alkyldimethylchlorid, 3,3g Quaternary ammonium,C12-14- Alkyl[(ethylphenyl)methyl]dimethyl-Chloride, Isopropanol. Duke vendosur vetëm një komponim të detajuar me gramazhë për çdo përbërës, autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 28 përkatësisht paragrafit 2 të këtij neni ku specifikohet se Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit.

Paneli Shqyrties konform ekspertit shqyrties/teknik sqaron se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar dhe duhet të jetë e caktuar përbërja aktive e Dezinfektuesit për procesin DDD, pasi që veç janë të testuara komponimet e aktiv të ammoniumit me reference për eliminim të COVID-19), komponimeve të peroksid hidrojenit (H_2O_2), por jo edhe në detale në mënyrë shumë te hollësishme dhe plotësisht ka të drejtë OE ankues, ndërsa nuk është kërkuar letër reference për dezinfektuesin që ka ndikim në eliminimin e COVID-19 e lëshuar normalisht nga organet kompetente: CDC-Centers for Disease Control;

WHO- World Health Organization;

ECDC- European Centers for Disease Control.

Lidhur me pretendimin e katërt të OE ankues se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve), duke shtuar se mjafton t'i shihni përgjigjet ne 3 pretendimet tona. Ne pretendimin e parë ka thënë se gramazha e cekur nuk e kufizon numrin e dezinfektueseve. Qysh është e mundshme të ketë një përgjigje të tillë autoriteti kontraktues. Një gramazhë e cekur e përberjes aktive të dezinfektuesit siç e ka vendos AK në specifikacionin teknik të kësaj dosje tenderike jo që e specifikon por i eliminon komplet dezinfektuesit tjerë e me këtë rast edhe operatorët ekonomik tjerë. Duke parë qëllimin e kësaj kontrate që është luftimi i COVID-19, ne ju kemi ofruar sugjerimet e organeve kompetente që

merren me luftimin e COVID-19 (CDC-Centers for Disease Control; WHO- World Health Organization; ECDC- European Centers for Disease Control), ndërsa autoriteti kontraktues ka ofruar në specifikacion një dezinfektues i cili nuk ka referencë për luftimin e COVID-19. Pra autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 te LPP-se si dhe nenin 28 te LPP-se. Ky specifikacioni i autoritetit kontraktues nuk është profesional dhe as ligjor për luftimin e COVID-19, si dëshmi është mungesa e referencës për luftimin e COVID19 nga organet kompetente që merren me luftimin e COVID-19 (CDC-Centers for Disease Control; WHO- World Health Organization; ECDC- European Centers for Disease Control).

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se ky pretendim ankimore është i bazuar sepse duhet të jetë e caktuar përbërja aktive e Dezinfektuesit për procesin DDD, pasi që veç janë të testuara komponimet e aktiv te ammoniumit me reference për eliminimin te COVID-19), komponimeve të peroksid hidrogenit (H_2O_2), por jo edhe ne detale në mënyrë shumë te hollësishme dhe plotësisht ka të drejtë OE ankues, sepse AK ka treguar dhe ka sqaruar se në gramazhë që masa, sasia dhe cilësi e kompnimeve për procesin e DDD duhet të jetë në forme standarde edhe jo përzierjet e komponimeve të jenë më të holluara në gramazhë që nuk do të kenë efekt kundrejt cov 19, apo edhe jo shumë të përqendruara sa mund ta dëmtojnë edhe florën e faunën apo edhe njerëzimin, nëse janë me përqendrimi në gramazha më të larta se sa standardet.

Lidhur me pretendimin e pestë të OE ankues se AK Ka vepruar në kundërshtim me nenin 65 (Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve), përkatësisht paragrafin 1 sepse me rastin e vendosjes së një specifikacioni të tillë teknik rezulton se neni i mësipërm i LPP-së me të 3 nënparagrafët është shkelur nga ana e autoritetit kontraktues. Edhe pse jemi në fazën tenderuesi, ne po e specifikojmë këtë për arsy se ka të bëjë me specifikacionin teknik dhe kur ne shohim se specifikacioni teknik është i orientuar, i dedikuar dhe i specifikuar në atë mënyrë që i eliminon të gjithë dezinfektuesit tjerë e rrjedhimisht operatorët tjerë padrejtësisht. E aq më shumë kur qëllimi i kësaj kontrate është luftimi i COVID-19 dhe ne shofim se kërkesa e dezinfektuesit as nuk ka referencë për luftimin e COVID-19.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim është i bazuar sepse kërkesa e dezinfektuesit as nuk ka reference për luftimin e COVID-19. Ndërsa autoriteti kontraktues ka ofruar në specifikacion një dezinfektues i cili nuk ka referencë për luftimin e COVID-19, pra autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar dhe zbatuar nenin 7 të LPP-se si dhe nenin 28 të LPP-së dhe se ky specifikacioni i autoritetit kontraktues nuk është profesional dhe as ligjor për luftimin e COVID-19, sepse ka mungesa dëshmive faktike dhe të argumentuara dhe se është mungesa e referencës për luftimin e COVID19 nga organet kompetente që merren me luftimin e COVID-19 (CDC-Centers for Disease Control; WHO- World Health Organization; ECDC- European Centers for Disease Control).

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit teknik, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues me rastin e përpilimit të specifikimit teknik ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që ti bëjë ndryshimet e nevojshme në dosje të tenderit duke marrë për bazë sqarimet sipas ekspertit shqyrtues/teknik.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenović

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK– Komuna Prishtinë
- 1x1 OE “Lulzim Katanolli B.I”,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.